

ILIRIA

XXXVI

2012

Roberto PERNA, Dhimitër ÇONDI

HADRIANOPOLIS

Gjatë vitit 2011 u zhvillua një fushatë me qëllim studimin e materialeve të gjetura dhe realizimin e hartës arkeologjike. Elementet që studiuam, me karakter territorial, duket se përkufizojnë një kuadër sipas të cilit gjatë periudhës helenistike parapëlqehet të zaptoheshin hapësirat kodrinore ose vendet e larta, ku mbrojtja ishte më e thjeshtë. Shpesh bëhet fjalë për fshatra (ose zona) të fortifikuara, në disa raste fortifikime të përmasave të vogla (posta), por në pozicione shumë strategjike. Në periudhën romake vërehet një tendencë për të zbritur e për t'u përqendruar përgjatë luginës, në bazë të një modeli që i ka fillesat në fund të epokës helenistike.

Nga data 1 deri më 29 korrik 2011 në qytetin antik të Hadrianopolit u realizuan gërmimet e përvitshme (Fig. 1). Qëllimi i këtij viti ishte vijimi i gërmimeve brenda qytetit romak, perimetrin e të cilit e njohim tashmë, zgjerimi dhe thellimi i zonës së gërmimeve të kryera deri në vitin 2011 përballë teatrit, zonë që është pjesërisht e zënë nga një ndërtesë me karakter termal.

Kërkimet u përqendruan edhe në hetimin e skenës së teatrit. Në veçanti u sqarua se vijimësia si e kanalit II, dhe e atij I, ndërpritet nga një devijim. Kanali i parë është realizuar nga dy copa, guri të latuara dhe shërbente për të sjellë ujë nga sistemi i shkarkimit që është gjetur në jug të banjave; i dyti është realizuar me materiale të përdorura edhe në zonën e jashtme në perëndim të banjave, gjatë shek. III pas Kr. Vazhdimi i gërmimeve bëri të mundur arritjen e niveleve më të thella të zonës, që në kohën e ngritjes së ndërtesës monumentale të banjës termale ishte ndoshta e lirë.

Për sa i takon rendit kronologjik, nga ndërtimet e identifikuara mund të supozohet se strukturat më të hershme i takojnë periudhës së Hadrianit, periudhë gjatë së cilës ndodh edhe organizimi i fazës së parë të ndërtimeve të banjës.

Realizimi i kanalit që shkon paralelisht me ndërtimin e një vaske të identifikuar gjatë vitit 2010 është pjesë e riorganizimit të zonës që në aspektin kronologjik i përket shek. VI p.Kr, kohë gjatë së cilës zona pësoi një riorganizim të pjesshëm të hapësirës me funksione të reja. Edhe në hapësirën e zënë nga një ndërtesë në formë katrore – ndoshta tempull – bëhet fjalë për struktura ku është mbështetur tempulli, të cilat kanë



Fig. 1. Hadrianopolis. Pamje e gërmimit.

vijuar të jenë funksionale edhe gjatë transformimit në kishë të këtij objekti. Gjithashtu, në pjesën jugore, gërmimi ka ndihmuar për identifikimin e niveleve të rrugës ku gjendeshin strukturat e një ndërtese antike.

Gërmimet u kryen edhe brenda mjedisit të tempullit, kryesisht në qendër, ku u identifikua një kanal që përshkon ndërtesën në mënyrë gjatësore. Kanali paraqet disa faza: e para përbëhet nga dy parete që risistemohen me realizimin e disa trakteve muresh, që ndiqen nga një tjetër risistemim i katit. Për sa i takon lidhjes nga ana kronologjike e ndërhyrjeve, mund të supozojmë se fazat më të hershme i përkasin periudhës së vonë flave. Bëhet fjalë për ngritjen e ndërtesës dhe të kateve përkatëse. Në mungesë të të dhënave të sakta stratigrafike, të cilat i presim nga studimi i materialit, elementet që kemi për momentin në dispozicion lidhen me riorganizimin e kanaleve dhe të sistemit të kateve me pllaka guri gëlqeror, veprimtari të kryera këto me shumë gjasa gjatë periudhës së Hadrianit.

Teatri

Gjatë gërmimeve të vitit 2011 u ndërmorën kërkime arkeologjike edhe në teatër dhe veçanërisht në zonën e skenës (Fig. 2). Duhet theksuar se zona e kërkimeve përfshinte një kuadrat me orientimin verilindje, në mënyrë që të bëhej i mundur analizimi i raporteve stratigrafike me strukturën kryesore që lidhet me teatrin. Gërmimet bënë të mundur nxjerrjen e disa informacioneve me rëndësi mbi historinë e hershme të monumentit. Nisur nga koha e ndërtimit të teatrit, ndoshta muri që kufizon skenën në



Fig. 2. Hadrianopolis. Pamje e teatrit.

veri bashkë me murin ballor i përkasin periudhës së Hadrianit. Së njëjtës fazë i përkasin edhe muret e tjera ku gjenden vendet (vrimat) që shërbenin për të mbajtur dërrasat ku mbështetej skena.

Në një fazë të mëvonshme, që i takon shek. IV pas Kr., ka pasur ndoshta një riorganizim të ndërtesës që ka parashikuar sistemimin e dy mureve përpara një blloku për të mbajtur perden, si dhe mbylljen e harkut që lejonte kalimin në ambientet e tjera që gjendeshin poshtë skenës. Duke nisur nga shek. VI pas Kr., ndërtesa është braktisur pjesërisht: në skenë janë grumbulluar materiale dhe mbetje, ndoshta pjesë e ndonjë aktiviteti artizanal, para se të ngrihej një mur i madh që ndërpret skenën, i cili daton ndoshta në fund të shek. VI pas Kr.